



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 11.7 MW që përbëhet prej tri (3) njësi gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Mal 6.8 MW, HC Erenik 2.5 MW dhe HC Jasiq 2.4 MW, të gjitha në komunën e Junikut, të datës 29.04.2011, të ndërmarrjes “Triangle General Contractors - Inc” Branch Kosova, me adresë rruga “Fusha e Pejës” p.n., KK Pejë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 24 dhjetor 2012 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Triangle General Contractors- Inc” Branch Kosova, ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, me kapacitet të instaluar prej 11.7 MW që përbëhet prej tri (3) njësi gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Mal 6.8 MW, HC Erenik 2.5 MW dhe HC Jasiq 2.4 MW, të gjitha në komunën e Junikut.
- II. Aplikantit “Triangle General Contractors- Inc” Branch Kosova, mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenin 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II të këtij Vendimi.
- IV. Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “Triangle General Contractors- Inc” Branch Kosova për dy (2) vite, dhe obligon aplikuesin që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim për lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga uji.



Arsyetim

- ZRRE me datë 29.04.2011 nga ndërmarrja “**Triangle General Contractors- Inc**” Branch Kosova ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 11.7 MW që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Mal 6.8 MW, HC Erenik 2.5 MW dhe HC Jasiq 2.4 MW, të gjitha në komunën e Junikut.
 - ZRRE pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar